



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.02.2020

Ref: 151/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016) Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), mori:

V E N D I M

Për korrigjimin e vendimit Nr. 437/12, datë 06.07.2012 për Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë

- I. Korrigjohet (ndryshohet) pika II, nënpika 1, e vendimit të KShC-së Nr. 437/12, datë 06.07.2012, si vijon:
 - Administrim Biznesi (BA)
 - Kontabilitet dhe Financa (BA)
 - Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë (BA)
- II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. 437/12, datë 06.07.2012, mbetet e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" ka parashtruar kërkesë për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 437/12, datë 06.07.2012, në pikën II nënpika 1. Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, është konstatuar se gjatë formulimit të vendimit Nr. 437/12, është bërë një lëshim teknik ku programet Administrim Biznesi (BA), Kontabilitet dhe Financa (BA) dhe Menaxhim i Turizmit dhe Hotelerisë (BA) janë përshkruar si specializime të programit Administrim Biznesi (BA), e që është dashur të përshkruhen si programe të veçanta. Prandaj përmes këtij vendimi, mbi bazën e dëshmive të ofruara, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti "Haxhi Zeka", Pejë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë